

## Punësim ilegal? Ju kini të drejta dhe pretendime!

Nëpërmjet zbatimit të direktivave të sanksioneve të BE-së, punëmarrësit pa të drejtë qëndrimi mund të vendosin të drejtat dhe pretendimet e tyre kundrejt punëdhënësve, të cilët bëjnë fitime nëpërmjet punësimit ilegal të të huajve. Kjo vlen edhe për **azilkërkuës** dhe të huaj/a me një lejë **tolerimi**, të cilët janë të zënë me punë pa lejë pune.

→ Ju kini të drejtën, **të merrni pagë për punën tuaj**.

→ Nëse ju ose punëdhënësi nuk mund të vërtetoni një marrëveshje tjetër, ju kini **të drejtën**

- të kërkonit pagën **minimale** (të vendosur nëpërmjet të ligjit ose marrëveshjesh tarifore) ose
- të kërkonit **pagën e zakonshme në këtë degë**.

Në çdo rast vlejné rregullat gjermane për pagën.

→ Nëse ju ose punëdhënësi juaj nuk mund të vërtetoni asnjë gjë tjetër, niset nga kjo, se marrëdhënia e punësimit ka zgjatur të paktën **tre muaj**.

→ Në rast të kthimit tuaj në vendin e prejardhjes suaj, punëdhënësi duhet të **paguajë kostot për transferimin** e pagës.

→ **Dhe nuk është vetëm punëdhënësi juaj direkt, i cili është përgjegjës në një rast të tillë - mundet të jetë po ashtu ndërmarrja e përgjithshme ose çdo ndërmarrje e futur ndërmjet!**

## Ju mund t'i mbronit të drejtat tuaja!

→ Ju duhet të kërkonit kundrejt punëdhënësit tuaj **të merren parasysh pretendimet tuaja për pagën**. Nëse ai nuk paguan, atëherë ju mund ta kërkonit pretendimin tuaj me padi dhe pas një vendimi pozitiv ta lini atë të zbatohet. Kjo është e mundur **edhe pas kthimit** në vendit tuaj të prejardhjes.

→ Ju mund të lini t'ju mbështetin, për të kërkuar të merret parasysh paga e papaguar. Kjo **mbështetje do të ofrohet** pa pagesë nëpërmjet organizatave të përmendura në faqen mbrapa ose nëpërmjet avokatëve privatë, të cilët në rast të dhënë do të paguhet nga shteti.

→ Ju lutemi merrni parasysh se në Gjermani për pretendime rroge ka një afat parashkrimi prej tre vjetësh dhe se mund të ketë edhe afate të tjera.

## Ju mund të merrni një lejë qëndrimi!

→ Nëse ju kini punuar **nën kushte veçanërisht shfrytëzuese** (edhe si punëmarrës i huazuar) ose nëse jeni **i mitur**, ju mund të bëni kërkesë për një lejë qëndrimi të kufizuar. Kushti paraprak është, që

- prokuroria ose gjykata të dojë t'ju dëgjojë personalisht si dëshmitar në një procedurë penale kundër punëdhënësit dhe
- ju të jeni i gatshëm të depononi si dëshmitar.

→ Në këto raste autoriteti juaj për të huajt mund t'ju japë një **afat më të gjatë largimi**, me qëllim që ju të mund të vendosni, nëse ju dëshironi të depononi si dëshmitar në një procedurë penale.

→ Leja e qëndrimit mund të zgjatet, deri sa ju të kini marrë **pagën tuaj**, nëse vendosja në vend e pretendimeve për rrogë nga jashtë shtetit paraqet për ju një vështirësi të veçantë.

## Pasoja të tjera për punëdhënësit, të cilët marrin përfitim nga punësimi ilegal

→ Nëse ju jeni punësuar ilegalisht, punëdhënësi juaj, i cili përfiton nga puna juaj, mund të ndiqet penalisht.

→ Punëdhënësi si rregull duhet të mbartë **kostot për çuarjen mbrapa** të punëmarrësit.

→ Punëdhënësi është i detyruar, të paguajë një kontribut në përputhje me **kontributet e zakonshme të taksave dhe sigurimeve shoqërore**, të cilat ai duhet t'i kishte paguar në rast të një punësimi legal.

→ Punëdhënësi mund të përjashtohet për një periudhë deri në pesë vjet po ashtu edhe nga ndihmat publike, subvencionet, mjetet financiare të BE-së dhe nga procedurat e caktuara të dhënies publike. Ai mund të jetë i detyruar, të paguajë mbrapa kontributet përkatëse të marra.

## Informacione të përgjithshme të mëtejshme për mbrojtjen e punëmarrësve/punëmarrëseve ju gjeni nën:

[www.ilo.org](http://www.ilo.org)

Das Faltblatt ist die Weiterentwicklung eines im ERF-Projekt ASAW erstellten Produkts.

## Mos lejoni të shfrytëzoheni!


Këtu ju merrni falas informacione, udhëzime dhe këshillime të mëtejshme:



Herausgeber: Caritasverband für die Diözese Osnabrück e.V.  
Dr. jur. Barbara Weiser & Stephan Kreftsiek  
Knappsbrink 58 - D 49080 Osnabrück  
Tel.: +49 (0)541 34978 - 218  
Fax: +49 (0)541 34978 - 4218  
bweiser@caritas-os.de  
Stand Januar 2019



**I PUNËSUAR  
PA LEJE?  
KA TË DREJTA  
DHE PRETENDIME!**



**INFORMACION PËR AZILKËRKUES  
DHE TË HUAJA/HUAJ  
ME NJË LEJE TOLERIMI;  
TË CILËT JANË TË PREKUR NGA  
SHFRYTËZIMI NË PUNË**